

Strategji : Si prindërit mund të ndihmojnë në rritjen e sjelljeve pozitive në shkollë

- Prindërit kanë një rol aktiv në shkollën e fëmijëve të tyre. Ata zhvillojnë takime periodike me stafin dhe mësuesit e shkollës, për të diskutuar çështje të ndryshme.
- Prindërit angazhohen në bashkëpunime të ngushta me nxënësit dhe mësuesit.
- Prindërit angazhohen në pjesëmarrjen në mënyrë vullnetare në aktivitetet dhe punët e shkollës (punë në klasë, shkollë, bibliotekë, oborr).
- Prindërit janë modele pozitive. Ata i zgjidhin konfliktet në mënyrë paqësore dhe arrijnë që të menaxhojnë efektivisht zemërimin dhe inatin.
- Prindërit diskutojnë në mënyrë të rregullt me fëmijët e tyre. Bisedat përfshijnë të gjitha temat dhe karakterizohen nga mosgjykimi dhe pranueshmëria. Ky lloj komunikimi duhet të jetë një ritual i përditshëm dhe jo thjesht një reagim ndaj ngjarjeve emergjente.
- Prindërit në mënyrë paraprake vendosin kufizime të qarta për sjelljen. Gjithashtu, prindërit diskutojnë me fëmijët dhe vendosin shpërblimet dhe ndëshkimet. Kjo teknikë, e përdorur në mënyrë konsistente, iu mëson fëmijëve një aftësi shumë të nevojshme edhe përgjatë rritjes, vetë-disiplinimin.
- Prindërit diskutojnë në mënyrë të qartë rreth çështjeve të dhunës, duhe pohuar se nuk pranojnë dhe tolerojnë sjellje agresive. Prindërit shpjegojnë me detaje se çfarë është dhuna dhe iu përgjigjen të gjitha pyetjeve të fëmijëve.
- Prindërit vazhdimisht dëgjojnë idetë dhe shqetësimet e fëmijëve të tyre. Duke zgjidhur problemet e vogla, parandalohen shqetësimet e mëdha që mund të vijnë si pasojë e moskomunikimit dhe dhunës.
- Prindërit iu mësojnë fëmijëve aftësi sesi të shqyrtojnë dhe të zgjidhin problemet. Fëmijët që dinë t'i trajtojnë problemet në mënyrë efektive, shfaqin më pak frustrim, inat dhe sjellje të dhunshme.
- Prindërit shkurajojnë ngacmimet dhe talljet, të cilat shpesh avancojnë në konflikt fizik. Ngacmimet apo talljet, qofshin të dhunshme ose jo, mund të nxisin personin e venë në lojë që ta shikojë dhunën si të vetmen formë ndaluese.
- Prindërit janë gjithë kohës në dijeni të vendndodhjes dhe aktiviteteve të fëmijëve të

tyre.

- Prindërit njohin shokët dhe shoqet me të cilët kalon kohën fëmija.
- Prindërit janë të kujdesshëm dhe vigjilentë për të kuptuar sjelljet apo shenjat që mund të jenë paralajmërime për shqetësime.
- Prindërit punojnë me prindërit e tjerë për të krijuar aktivitete dhe për të mbështetur shkollën në ndërtimin e standarteve sa më të larta.
- Prindërit deklarojnë hapur se mbështesin politikat dhe rregullat e shkollës që ndihmojnë në krijimin e një vendi të sigurtë për të mësuar dhe zhvilluar tek të gjithë nxënësit.
- Prindërit iu shpjegojnë fëmijëve arsyet pse rregullat që përkrahin sjelljet pozitive janë të drejta dhe duhet që të zbatohen.
- Prindërit diskutojnë me fëmijët sesi rregullat mund të funksionojnë më mirë.
- Prindërit krijojnë klube me bazë shkolle dhe komuniteti, për të diskutuar rreth problemeve të dhunës, shqetësimeve të të rinjve, burimeve mbështetëse dhe aftësive të nevojshme drejt orientimit për sjellje pozitive.